




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	DPKI	Nr. Prot.	06-1753/20
Dep.		Br. Prot.	
Nr. i faq.		Prot. No.	
Broj stranica	02	Data	26.08.2020
Nr. pages		Datum	
		Date	
PRISHTINË			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.08.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-1109/12*, për zyrtarin e lartë publik z. Ukshin Ismaili, Drejtor Klinik në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korrupsionit ka hapur rastin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Ukshin Ismaili, Drejtor Klinik në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, të cilin rast e ka trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Ismaili, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtari i lartë publik, respektivisht, Drejtor Klinik në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, njëkohësisht i njëjti mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat "Ukshin Ismaili" B.I.

Për t'i vërtetuar dyshimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare me numër DPKI-06-01-/516/20 është konstatuar se z. Ismaili mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat.



Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-1267/20, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Ismaili, i njëjti ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit për tu sqaruar lidhur me situatën e konfliktit të mundshëm të interesit. Me këtë rast, Agjencia e ka njoftuar për papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik, konkretisht me atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”.

Pas kësaj, i njëjti është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare DPKI-06-1267-1/20, me të cilën dëshmohet se z. Ismaili ka bërë shuarjen e biznesit në të cilin ka qenë person i autorizuar.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Ismaili, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOLLI
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

